

Në bazë të nenit 11 të Ligjit mbi qasjen e lirë në informacione („Fleta zyrtare e Malit të Zi“, nr.44/12, 30/17, 066/25) dhe në pajtueshmëri me nenin 5 paragrafin 1, pika 8 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat komunale”, nr. 022/23, 024/23, 029/24, 032/24, 012/25), sekretarja e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale e komunës së Tuzit, **s j e l l**

UDHËZUES

për qasje të lirë në informacione të Sekretariatit për vetëqeverisje lokale

Me këtë Udhëzues përcaktohen llojet e informacioneve në posedim të Sekretariatit për vetëqeverisje lokale të komunës së Tuzit (në tekstin e mëtejme: Sekretariatit), procedura për qasje në informacione, emri i personit të autorizuar për të vepruar sipas kërkesës për qasje informacioneve, shpenzimet e procedurës, mënyra e publikimit të Udhëzuesit dhe të dhënat e tjera me rëndësi për realizimin e të drejtave në qasje të informacioneve në posedim të Sekretariatit, në përputhje me ligj.

Me nenin 10 të Ligji mbi qasjen e lirë të informatave përcaktohet informata si dokument ose pjesë e dokumentit në formë të shkruar, shtypur, video, audio, formë elektronike apo tjetër formë, duke përfshirë edhe kopjet e tyre, pa marrë parasysh përmbajtjen, burimin (autorin), kohën e përgatitjes ose sistemin e klasifikimit.

I- TË DHËNAT THEMELORE

Emri i organit: Sekretariati për vetëqeverisje lokale

Selia dhe adresa: Tuz, Tuz pn,

Telefoni: 020/875-167

Fax: 020/875-167

e-mail: nedzmija.paljevic@tuzi.org.me, kristjan.gjokaj@tuzi.org.me

Fushëveprimi i punëve të Sekretariatit është i përcaktuar me Vendimin mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të komunës së Tuzit (“Fleta zyrtare e MZ- dispozitat komunale”, nr. 022/23, 024/23, 029/24, 032/24, 012/25)

II- LLOJET E INFORMACIONEVE NË POSEDIM TË SEKRETARIATIT

1. Evidencat zyrtare

- Evidenca në fushën e punës të parapara me ligj
- Regjistri i librezave të punës të lëshuara
- Regjistri i librezave vullnetare të lëshuara